Gjendet e djegur kamioneta e përdorur për tentim-grabitjen në magjistralen Prishtinë-Gjilan

09:12 | 9 Mars 2021

Policia ka gjetur të djegur, kamionetën e cila është përdorur për tentim-grabitjen në magjistralen Prishtinë-Gjilan.

Në raportin e policisë, thuhet se kamioneta është gjetur në fshatin Parallovë të Gjilanit.

“Është raportuar se në rrugën magjistrale Gjilan-Prishtinë (fshati Mramor) disa persona të maskuar, të armatosur me armë të gjata me një kamionetë me targa vendore, kishin ndaluar automjetin e kompanisë me të cilin kryhej transporti i parave, në të cilin ndodheshin katër meshkuj kosovarë.

Të dyshuarit kishin gjuajte me armë zjarri në drejtim të viktimave ku si pasoj janë plagosur dy prej viktimave. Viktimat janë dërguar në QKUK për tretman mjekësor. Kamioneta të cilin e kishin përdorë të dyshuarit është gjetur e djegur në fshatin Parallovë të Gjilanit.

Në vendin e ngjarjes përveç njësive policore ka dalë edhe prokurori i shtetit, nuk raportohet për të arrestuar, rasti vazhdon të hetohet”, thuhet në raport./arbresh.info/

Shpërndaje në rrjete sociale

Lajmet më të lexuara

Të ngjashme

Gjendet e djegur kamioneta e përdorur për tentim-grabitjen në magjistralen Prishtinë-Gjila...
09:12 | 9 March 2021

Meliza Haradinaj-Stublla jep dorëheqje
09:09 |

Nushi: Pallati i Rinisë dhe 13 shtëpizat në “Gërmi” të gatshme për pacientët me COVID-19
08:52 |

Foto lajm

Osmani dekoron me urdhrin “Shotë Galica” tetë gra

21:20 | 8 Mars 2021

© Arbresh.info 2015-2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.